

## PËRSHKRIMI UDHËTIMEVE TË EVLIJA ÇELEBIUT NËPËR ÇAMËRI E MOLLOSI

Shehu helvetjan turk, Evlija Çelebiu qarkulloi tri herë nëpër tokën shqiptare, që asokohe ishte në përbërjen e Sulltanatit Osman dhe emërtohej **Arnavutlluk**: më 1660 nëpër pjesën e saj veriore, më 1662 nëpër të mesmen, ndërsa më 1670 nëpër jugun e saj. Kjo pjesë përbëhet nga Çamëria dhe Mollosia. Çamëria, ose brezi tokësor anës Detit Jon, zgjatet 110-115 km nga Gjiri i Prevezës drejt veriut dhe shtrihet 36 km nga buzëdeti drejt lindjes, duke u përmbledhur brenda një sipërfaqeje prej rreth 4140 km<sup>2</sup>. Kurrizi malor lindor Dodonë-Mali i Gjerë e veçon nga Mollosia, trevë me sipërfaqe mbi 5000 km<sup>2</sup>. Ky brez tokësor iliriano-jugor prej rreth 9.000 km<sup>2</sup>, që prej lashtësisë është mësyre nga një varg pushtuesish, ngase përbënte udhëkalimin më të përshtatshëm Lindje-Perëndim.

Sapo Ali Pashai i largoi venecianët nga Gjiriti dhe Moreja, dërgoi Evlija Çelebiun në Shqipëri që të kërkonte ushtarë dhe muratorë për ndërtimin e kalasë në Zërnatë. Kjo kala duhej për mbrojtjen e Mënit që kërcënohej nga venecianët. I nisur prej Moreje, ai zbriti në ujdhesën joniane, Lefkadhë 4 e prej andej u hodh në Prevezë - qyteti më jugor në trungun tokësor shqiptar, i ngritur në mesjetë si një ushtarake veneciane. Druprëresit e qymyrbërësit shqiptarë të fshatrave të Çamërisë Jugore, e cila në lashtësi quhej **Qasopî**, e bënë qendër shitblerjeje me tregtarët e huaj, më shumë me banorët grekë të ujdhesave përballë. (Shih I. D. Hoxha, «Enciklopedi Jugshqiptare» I, Tiranë, 2009, fq. 645-667).

### I

Evlija Çelebiu(5) tregon se në kohën e arritjes së tij në Prevezë kishte 350 shtëpi, 100 shitore, një xhami - atë të Sulejman Hanit - një teqe, tre mesxhida lagjesh, një medrese, një mektep, një han dhe një kala; ku qëndronin roje 50 ushtarakë. Brenda saj kishte

100 shtëpi të vogla pa bahçe. Rrugët e brenda kalasë të ngushta dhe pa dritë. Në anën lindore kalaja kishte një derë mbi të cilën shkruhej: «Kjo kala u ndërtua në vitin 960 hixhri -kohë e mbretërimit të Selimit, djalit të sulltan Sulejman Hanit. Në të djathtë të hyrjes ka të gdhendur në gurë krerët e një dashi dhe të një deleje që ngajjnë sikur janë të vërtetë. Në kala hyhet nëpërmjet një ure e cila është ndërtuar mbi hendekun». Kalaja e Prevezës qeverisej prej subashit; të ardhurat e saj i kaloheshin Beut të Janinës. Preveza -vëren ai- ka kopshte(bahçe)të panumërta. Qyteti ka një port në të cilin qëndronin tri fregatë(6). Në veri të portit, një gjysëm ore larg kalasës ka një port të vogël që nxë 200 anije; në fund të këtij porti ndodhet Preveza e vogël(7).

Prevezanët -thekson Evlija Çelebiu- janë shtatlartë, shumë trima dhe të ndershëm. Veshin tesha algjeriane, pasi të gjithë janë detarë dhe mbrojnë brigjet e Poljas e Kalarës brenda gjirit të Venedikut.

## I

**Kalaja e Prevezës së vogël**, është e shkatërruar. Nuk ka asnjë vepër njeriu. Mirëpo nën këtë kala të shkatërruar qëndrojnë të gjitha anijet pa hedhur spirancë.

**Kalaja e madhe dhe e vjetër e Prevezës**; në botë nuk është ndërtuar ndonjë kala e tillë. Tani është e shkatërruar, por brenda ka çifligje të mëdha dhe të mirëmbajtuara. Nuk ka një të tillë të ngjashme në botë. Ndoshta mund të krahasohet me kalanë e Stambollit dhe me Harabistanin në qytetin Dadjan të Irakut. Ndoshta është më e madhe se kalaja e Stambollit, e Antakjas dhe e Kavallës. Dy ditë nuk të mjaftojnë për t'i rënë rreth e rrotull. Në këtë qytet të madh kanë sjellë ujë të pijshëm me anë të dy gemerëve (tubacione) të mëdha. Mahnitesh kur e sheh këtë qytet.

Pasi pa mirë e mirë atë qytet të vogël në mbarim të siujdhezësës - port kryesor në jug të trungut tokësor shqiptar dhe nga çdo pikëpamje me rëndësi të pakrahasueshme në atë krah të venditshkoi në ish-qytetin e hershëm aq të dëgjuar, Nikopól. Për disa orë u hodhi një sy vjetërsirave të vetëruajtura ende deri asokohe e prej andej shkoi në Lûr; me atë rast pa edhe mbeturinat e ish-qytet-fortesës së fuqishme mesjetare, të quajtur «Róg». Mbas shënoi gjithçka tërheqëse, mori udhën drejt lindjes; kapërceu

lumin Aràht dhe u hodh në Nartë -qytet i lashtë në skajin jugor të Mollosisë parahistorike- i ngritur në ish-buzëgjirin verior të mëngës detare.

Qyteti (jashtë kalaje) i Nartës ka rreth 2.000 shtëpi me tjegulla, të pajisura me bahçe dhe me shatërvane. Ka 17 lagje. Vetëm 3 janë lagje muslimane. 4 lagje janë të hebrevje dhe 10 të grekëve. Nuk ka armenë dhe francezë. Por latinë ka plot. Ka 6 xhami. Dy xhami janë brenda kalasë. Brenda pazarit lartësohet xhamia e sulltan Bajazidit. Kjo xhami ka një xhemaat të madh. Në anën jugore të qytetit ndodhet Xhamia e Teqesë. Ka edhe mesxhide. Është mesxhidi i Babait, pranë sarajit të Jusuf beut dhe mesxhidi Dizdar. Ka tre medrese dhe më e mira është medreseja e sulltan Bajazid Veliut. Ka pesë mektebe sibjanë. Ka tre teqe dervishësh. Në rrugën për në xhaminë e sulltan Bajazid Veli Hanit ndodhet një han i madh tregtar. Afër tij ka një kullë të madhe me orë. Këmbana është shumë e madhe dhe bie sa herë që është orë e plotë. Kulla është një vepër e madhe arti. Ka hamame, 400 dyqane. Ka shumë prodhues thikash dhe këpucësh. Gjendet çdo lloj malli i shtrenjtë apo i lirë. Kafenetë janë në cep të kalasë. Disa rrugë janë me kalldrëm. Nuk ka asnjë çezmë në qytet. Uji nxirret nga 1700 puse. Ujin e lumit të Nartës që kalon nëpër qytet, nuk e konsiderojnë të pijshëm dhe pinë nga burimet. Klima nuk është e mirë. Ata që nuk e durojnë të nxehtin, shkojnë për verim në vende të ndërtuara ndërmjet shkëmbinjve të bardhë në lindje të qytetit. Prandaj dhe shumica e njerëzve kanë ngjyrë si të verdhë. Shumica ecin në këmbë gjatë verës. (8) Ka 10 kisha. Në jug të qytetit në bahçet e jashtme është kisha e Kralit Latin. Ka 50 priftërinj. Është një vepër arti. Pranë sarajit të Jusuf agës ndodhet kisha e Patrikut, është gjithashtu një vepër arti. Ka shumë vakëfe në qytet. Në Nartë janë të famshme shegët. Prandaj dhe është quajtur Nartë(9). Janë të famshëm dhe portokalli, fiku dhe ulliri. Këto produkte edhe i eksportojnë. Shumica e popullsisë merret me tregti. Tregtojnë verë, i shijshëm është edhe pjepri. Në vijim të shtegtimit, duke ecur nëpër udhën e kushedisekurshme këmbësore, arriti në Janinë, kryeqendër e vilajetit me emrin «Jänja vilajeti».(10)

Në faqet 646-656 të “Sejjahatnamesisë” Evlija Çelebiu(11) shënon të dhëna deri atëherë fare të panjohura nga bota. Përshkruan qytetin, tregun e tij e gjithçka tjetër që pa e shkeli

atje. Tregon se asokohe Janina përbëhej prej 38 lagjeve, brenda të cilave përmblihdeshin 4.000 shtëpi të rrethuara me kopshte dhe vreshta si edhe shumë saraje të mëdha, të ngjashme me kalatë. Pazari -vëren ai- përbëhej nga 1900 shitore e kafene, njëra prej të cilave nxë 500 vetë; brenda qytetit kishte edhe një lulishte madhështore -të ndërtuar me nxitjen dhe ndihmën e Ihsan Efendiut- si dhe kullën e sahatit, e lartë 12 metërshe etj. Flet edhe për kalanë «E gurtë» apo «**Shkëmbore**», të quajtur «**Litharica**», e cila mbivëzhgohej (mbisundohej) nga gërbja (kulla) përkatëse «**shumë e fortë**» 5-katshe. Në faqet e tjera të veprës në fjalë ai vëren edhe se Kalaja e sapopërmendur ishte «**ndërtuar mbi një brez të thepisur shkëmbor. Ajo është hedhur në dorë më 834 H./1430 nga Xhedik Ahmet Pashai, gjeneral shqiptar i kohës së shtetdrejtuesit, sulltan Bajazidii dytë**». Në «**Shtegtim përshkrimet e Shenjtit të sjellshëm**», Evlija Çelebiu përshkruan me hollësi edhe liqenin e Janinës, bukurinë e tij të rrallë si edhe gjallëresat që lëvrinin nëpër të. Ndër të tjera thekson edhe: «**Në liqen duken me mijëra peshq me ngjyra**»(12).

Pasi la Janinën, Evlija Çelebiu ndoqi udhën këmbësore nëpërmjet të cilën arriti në vendbanimin poshtë Dodónës të quajtur Zaravuç dhe prej andej zbriti në Çamërinë e Mesme, në lashtësi të quajtur Thesproti, emër ky i përngjitur shqip-greqisht: thes dhe próto.

Fillimisht shkeli në qytetin **Paramithi**, qytet i ndryshequajtur **Ajdonat**; asokohe dhe vazhdimisht nga çdo pikëpamje -kryesisht ekonomike- ai ishte qyteti më kryesor në brendësi të Çamërisë. Evlija Çelebiu e quan «qytet shqiptar krejt i ri» (13), popullata e të cilit «**flet shqip dhe greqisht**». Evlija Çelebiu(14) thotë edhe: «**Kalaja** (e madhe -I. D. Hoxha) Kjo ka qenë pushtuar më 1449 nga Xhedik-Ahmet Pashai -i cili siç u përmend- ishte gjeneral shqiptar i kohës së sulltan Bajazitit II. Thotë se ajo (kalaja) ishte «**5-këndshe, e ndërtuar mbi një majë të thepisur shkëmbore. Brenda saj ka 7 shtëpi; në kala qëndrojnë roje 100 ushtarakë**». Në vijim ai shënon të dhëna shumë të vlefshme për vet qytetin, për jetën shoqërore, për marrëdhëniet e qytetarëve ndërmjet njëri-tjetrit, për folklorin, topografinë, moralin, zakonet e atjeshme dhe të të gjitha vendeve që përshkoi; shënon, gjithashtu, ngjarje dhe të dhëna me vlerë historike të qindvjeçarit të 17-të. Ai përshkruan me saktësi çdo të vërtetë me të cilat ndeshi dhe tregon

se asokohe në Paramithi kishte 800 shtëpi, shumica e të cilave shumë të bukura e me disa kate; ndër to dalloheshin –sidomos ato të Minko (Emin) Pashait dhe të Bejko Pashait. Në vazhdim ai shënon shtëpitë më në duk të pasura, të renditura si më poshtë: a) të Xhemo Mustafa Çaushtit, b) të Sin Dullës, c) ato në Lagjja e Re, ç) të Kalives e të Gallatit si dhe d) të Shënjt Nikollaut. Kishte, gjithashtu –thotë ai- edhe 250 hane, shitore e kafene, një banjë qytetëse etj. Në vazhdim tregon për shumëllojshmërinë e pemëve frutore, Sipas tij në Paramithi dhe rreth saj i tërë vëndi ishte i veshur dëndur me limonë, portokalla, shegë, ullinj e fiq të vendit, fikofrengj (**Ágris-màtha**) etj. **«Fiku Ágris-màtha është me nam»**, thekson ai; Mbivlerëson sidomos ullinj të që ishin më me shumicë se tërë drufrutoret e tjerë; vendësit ata i quanin **«Sulltanikë»**. Quheshin me këtë emër –vëren historiani grek, Vasil Krapsiti në veprën e vet **«I Istorìa tu Margaritju»**- për arsye se çdo vit nga Stambolli në Paramithi shkonin njerëz të ngarkuar posaçërisht për mbledhjen dhe për shpënie e tyre në Stamboll, kryeqyteti i atëhershëm i sulltanatit osman. Me urdhër të sulltanatit pasi i shpinin në Stamboll, i ndanin nëpër vezirët dhe zyrtarët e tjerë krerë e me rëndësi të veçantë. Në rrafshinën poshtë qytetit – thotë Evlija Çelebiu – kultivoheshin të gjitha llojet e perimeve dhe të drithërave; shumëllojshmëria e të mbjellave dhe prodhimitaria e lartë e tyre arrishej falë burimeve të shumta ujore si dhe përkushtimit për punë të banorëve të qytetit. Përshtypje të madhe i bënin qarkullimi tregtar në qytet dhe vizitat e shpeshë në të të tregtarëve frëngj. Ata venin atje nga portet veneciane të ujdhesës Korfuz dhe të portit të Sajadhës, port ky në anëdetin shqiptar çam përballë Korfuzit. Tregtarët në fjalë – vëren ai – blinin mallra dhe sende të ndryshme nga vendësit e i shpinin për t’i shitur në vende të tjera. Evlija Çelebiu e tërhiqnin veçanërisht bukuritë natyrore të vendit, të cilat ai i përshkroi aq bukur. Flet për klimën e këndshme, të lehtë në frymëmarrje dhe për mjedisin e shëndetshëm. Shumë përshtypje i bënin atij edhe veshjet e zakonet si dhe mënyra e sjelljeve të vendësve, për të cilat ai vëren: **«Paria në kokë mbajnë çallmë (feste), kurse në trup veshin tesha shumëngjyrshë; të rinjtë mbi krye vënë kësulë (qeleshe) të kuqe në formë koni dhe veshin tesha prej leshe; rreth mesit mbajnë brez mëndafshi, prej të cilit përherë varet një kamë»** (thikë majëmprehtë me dy teha I. D. Hoxha). Banorët e Paramithisë –vijon ai- janë të shkolluar dhe të zotët e fjalës (të gojës); në përgjithësi janë tregtarë, kurse disa janë punëtorë; këta vishen me tesha prej leshe dhensh, të mbërthyera me korkådhe

(pulla). Doemos që këtu e ka fjalën për pjesën e trupit nga mesi e lart, në të cilën vishej fanellë leshi dhe xhamadàn (I. D. Hoxha); ndërsa në pjesën e poshtme të trupit –thekson «**Shenjti i Sjellshëm**»- veshin vràka. (Lloj pantallonash prej leshi të dhurve, qepur sipas trupit –I. D. Hoxha). Të veshur kësisoj –vijon «**Shenjti i Sjellshëm**».- ata venë e punojnë. Banorët e qytetit –thotë-dallohen për mikpritjen, për miqësinë, për fqinjësinë e mirë dhe për mëshirën. Shëtitari në fjalë përmend disa prej familjeve më të fuqishme të asaj kohe në Paramithi; një prej më parësoreve të tyre thotë se ishte ajo e Bejko Pashait, e cila vazhdonte të jetonte prej shumë vitesh në atë qytet. Një tjetër familje me rëndësi thotë se ishte ajo e Muho (Muhedin) Çelepiut, e cila – thotë Evlija Çelebiu – zotëronte toka të pafund. «**Në oborrin e xhamisë “Mbret” është varrosur ndërtuesi i saj, i shenjti Mustafà Çauishi**». E quanin «**Xhamia Mbret**», sepse –sipas gojëdhënave të vendësve- në të ishte falur edhe vet sulltan Bajazidi II –(I. D. Hoxha). Në këtë xhami – po sipas gojëdhënave të vendësve, më e madhja, më e rëndësishmja dhe më e përdorshmja prej banorëve të atij qyteti – veç zbukurimeve dhe pajisjeve të tjera, ruhej edhe një kuti e veshur me kadife të posaçme formë belluzi, brenda së cilës ruhej me shumë-shumë kujdes e nderim e quajtur «**Ele-i Sâdet**» (15) 15. Qimja e Pejgamberit, a. s.). Ajo nxirrej nga xhamia dhe paraqitej para masës qytetare vetëm në raste tejet të rëndësishme gjithëqytetare apo gjithëkrahinore.(Shih, Ibrahim D. Hoxha, «**Enciklopedi Jugshqiptare**» II, T., 2009, fq. 556-570.

Në vazhdim të udhëtimit të vet nëpër Çamëri **Evlija Çelebiu**, pasi doli prej Paramithie, u drejtua për në Margëllëç, qytet në Çamërinë e Mesme perëndimore, i quajtur më parë «**Gjitanë**», ishte vendbanimi i dytë i Çamërisë ku Evlija Çelebiu ndaloi. Ky vendbanim mesjetar gjendet në fund të këmbëve jugperëndimore të masivit malor, të quajtur «**Bozhûr**», emër ky i njëlloj luleje të verdhë të ndezur që vetëmbin vetëm mbi atë masiv malor. Sipas përshkrimeve të disa historianëve të asaj kohe – dhe të mëvonshëm – ngritja filloi më 1438. Ndërtuesit fillestarë ishin një numër – duket jo dhe aq i madh- shqiptarësh të vajtur prej fshatit vendthate «**Ajgjî**»(Gjiri i Shenjtë, emërtim i përngjitur greqisht shqip); këta ish-pasardhës të toronitëve të lashtë që kishin zbritur kushedi kur në Pargë të Vjetër. Pastaj, për gjetjen e një vendjetese më të mirë, ishin zhvendosur paksa më në V-P të Pargës së Vjetër dhe kishin ngritur atje fshatin. Ata që e plotësuan vendbanimin dhe e ngjitën në shkallë qyteti ishin malësorë të zbritur nga fshatrat e

hershme të masivit malor «**Bozhûr**. Zbehtazi rrjedhën e ngjarjeve të atyre viteve dhe shtjellimin e tyre e përshkruajnë disa historianë, sidomos ata latinë; po, historiani helenist Vasil Krapsiti në veprën e vet «**I ΙΣΤΟΡΙΑ ΤΟΥ ΜΑΡΓΑΡΙΤΙΟΥ**», fq. 57 vëren: «**Sipas të dhënave të mia, përshkrimi i parë i qytetit Margëllëç na jepet nga udhëtari turk, Evlija Çelebiu**». Ai vë në dukje, se ky qyteti në fjalë ishte ndërtuar në një fushë shumë pjellore e se përbëhej nga 6 lagje me 1200 shtëpi prej mur guri, shumica e të cilave qarkuar me mur rrethues po prej guri; secila kishte kopshte e vreshta. Në qytet kishte dy xhami, një treg të madh me 15 shitore e kafene, dy hane, një hamam dhe një krua ujëshumë(17). Qyteti -thuhet në të- ishte «**pronë e Ahmet Pashait**» dhe se mbrohej prej një kalaje pesëkëndëshe «**tejet e fortë**», brenda së cilës gjendeshin 100 shtëpiza. Meqë vendi ishte malor-shkëmbor tejet i thyer e krejtësisht i pakalueshëm, kalaja ishte e pajisur vetëm me një portë, ana lindore. «**Banorët e kalasë -vëren Evlija Çelebiu- janë në skeptrin (pushtetin, mbrojtjen) e vet Sulltanit**». Kalanë -thekson ai- «**e pati ndërtuar një peshkatar i quajtur Margarit**»(18). Evlija Çelebiu, gjithashtu, dëshmon se qyteti ishte qendër-sundimi, rrethi i të cilit përmbliidhte 40 fshatrat përçark tij. «**Ky vend -vëren ai- në fillim u mor nga venedikasit**». Doemos që e ka fjalën për pushtimin venecian të vitit 1447/850 H. Por, më 1449 venecianët i përzuri prej andej dhe prej Narte gjeneral Gjedik Ahmet pashai, i cili -si edhe në Paramithi- në kala la vetëm rreth 10 vetë (ushtarë). Qëndrimin e tij në Margëllëç Evlija Çelebiu e përfundon me përshkrimin e kopshteve dhe të klimës shumë të mirë (19).

Dihet, më 1570 ushtria osmane i largoi venecianët prej Qipros dhe u vendos atje. Kjo ngjarje bëri që papa Piu të organizonte shpejt e shpejt një lidhje ushtarake të njësisë së vet të armatosur me njësitë e Spanjës e të Venecies. Duke zbatuar porositë e papa Piut, më 7.10.1571 luftanijet malteze, napolitane, savojàne e veneciane mësynë së toku flotën detare osmane të përqendruar para Nafpaktit, skelë në gjirin detar të Korinthis e të Lepàntos. Të goditura befasisht, luftanijet osmane pësuan dëme. E tronditur nga sa ndodhi, paria e Margëllëçit, duke «**e ndier dimrin**» venecian që paskëtaj doemos do të shpërthente furishëm, filloi me ngut ngritjen në qytetin e vet të një kalaje për t'u mbrojtur. Mirëpo Sebastiani, komandanti venecian në Korfuz, dërgoi nxitimthi kundër tyre 6.000 rrogëtarë të armatosur venecianë, korfjåtë e shqiptarë të krishterë pargaritë. Margëllëçasit u

mbrojtën me vetëmohim shembullor, po, duke qenë një pakicë e papërfillshme përballë tërë asaj mizërie, në mbrëmje kërkuan armëpushim me kushte jo përulëse. Për të mos shtuar humbjet e mëtejshme të pësuar gjatë asaj dite, komandanti i rrogëtarëve sulmues bëri sikur e pëlqeu, po pastaj, kur erdhi çasti i sajuar prej tij, ai e shkeli paturpësisht marrëveshjen; shembi kalanë dhe u bë zot i qytetit. Sundimi venecian mbi margëllëçasit zgjati pak. Me marrëveshjen osmano-veneciane të 7 marsit 1573, forcat veneciane u larguan për gjithnjë nga kishin ardhur. Margëllëçi iu ribashkua sulltanatit osman dhe popullata e tij e mërguar u kthye sërish në qytetin e vet.

### **Vendbanimi i tretë i Çamërisë së Mesme, ku ndaloi Evlija Çelebiu, u bë Pàrga, qytet në anëdetin jonik.**

Qyteti u ngrit nga pasardhësit e toronitëve, malësorë të qytetit Torón në Himerin e lashtë, por të shpërngulur prej andej kushedi se kur -ndoshta që pas shkatërrimit prej romakëve- dhe të vendosur në «**Ajgji**», fshat i themeluar prej tyre. Për gjetjen e një vendjetese më të mirë, rreth vitit 1300 ata zbritën në anëdetin poshtë fshatit të tyre dhe në fund të brezit të atjeshëm shkëmbor ngritën kalanë dhe ca kasolle brenda saj. Me kalimin e kohës ata zbritën edhe në ranishten anëdetare dhe filluan ngritjen atje të ndërtesave për banim të të shtuarve dhe të riardhurve nga fshatrat e afërme. Historiani shqiptar Marin Barleti dhe ai francez, Emil Izamberi dëshmojnë se në vitin 1385 qyteti në fjalë u përmbloodh brenda zotërimit të princshës Komita, e veja e princit shqiptar Gjergj Balsha II. Po, sipas disa dokumenteve të dyshimta veneciane, gjoja me vendim të pargaritëve, më 21 mars 1401 një përfaqësi e tyre shkoi në Korfuz dhe paska kërkuar mbrojtje prej sundimtarit venecian. Filloi kështu përzierja ushtarake e venecianëve në jetën e përditshme të pargaritëve; njëkohësisht edhe përplasja e pandërprerë me bashkëkombësit e tyre shqiptarë të vendbanimeve fqinje. Kur Evlija Çelebiu shkoi në Pargë, vuri re se si vendmbrojtje e qytetit shërbente kalaja mbi shkëmb, brenda së cilës gjëndeshin 60-70 shtëpi dhe 7-8 shitore e kafene(20).

Pasi shënoi edhe gjithçka iu duk tërheqëse, la Pargën, dhe -doemos nëpër rrugë detare- zbriti së Skalomë të Sajadhës, skelë në Çamërinë Veriore, në lashtësi e quajtur Kamanî e më pas

Sheshtrinë (a Qeshtrinë) dhe në mesjetë Banjoneti. Si shënoi ç'pa atje, u fut fare pak thellë në brendësi të vendit -deri në fshatin Lops- ku aty afër bejlerët **dinenj** kishin ngritur sarajet-kala të tyre. Është me të vërtetë për t'u habitur se përse Evlija Çelebiu nuk çau edhe pak km. më në lindje, ku gjendej i ngritur të paktën që në Mesjetën e hershme qyteti Filat, por u kthye në Skalómë të Sajadhës; prej andej kaloi në krahinën veriore fqinje, të quajtur Labëri. Gjatë udhëtimit nëpër të, së pari u ndal në Delvinë e pastaj në disa qytete e kala: të Gallatit Zhulàtit, Kardhiqit e dikur arriti edhe në Gjirokastër. Kudo ku shkoi, me vendësit ai krijoi marrëdhënie miqësore të atilla, që "shqiptari mund t'i bënte vetëm me një turk e me askënd tjetër". Po, në Gjirokastër – duket ngase atje banorët ishin muslimanë të tarikateve (sekteve), shpirtërisht të prirë nga dervishë, siç ishte edhe vet ai – marrëdhëniet e ndërsjella miqësore e mirëbesuese ndërmjet tyre arritën kulmin. Në një mjedis të tillë sundimtari i vendit, Zejnel Pashai, e zgjodhi krushk për të marrë nusen e të birit në fshatin Zharrovinë(21). Nisur prej Gjirokastre -bashkë me njëmijë kalorës dhe njëmijë këmbësorë të armatosur- ai mori udhën për në vendbanimin e nuses, i cili ndodhej 9 orë këmbësori në V-P të Janinës. Pas njëmbëdhjetë orësh udhëtimi nëpër fshatrat e Dropullit, në Peshkëpi -fshat në pllajën jugore të malit **Bureto**, të quajtur «**Rrëza e Zezë**»(22)- duke kaluar nëpër fshatin Kserovallto(23), ai dhe bashkudhëtarët e vet zbritën në Zharrovinë. Evlija Çelebiu thotë se Zharrovina ndodhej në buzë të një liqeni. Sot vendbanim me emër të tillë në ato anë nuk gjendet më kurrkund, po vetëm një liqen me emër disi të përafërt me të; në hartën ruse 1:200.000 shënohet me emrin: **(Ceravnna a Ceravina(24))**; mirëpo ai vendbanim me Delvinàqin është shumë afër, 5 km. Evlija Çelebiu thotë se udhëtimin në kthim prej Zharrovine në Delvinaq e përshkuan në 4 orë. Mbetet të besohet, pra, se Zharrovina duhet të ketë qenë në lindje të liqenit **Ceravnna (a Ceravina)**; **mendja e do që** të ketë qenë pikërisht në buzën jugore të liqenit, 2 km. në J-L të Dhulanait. Në hartën ruse të sapopërmendur, në vend të vendbanimit në fjalë gjendet një shenjë sendtreguese. Evlija Çelebiu tregon se ai vendbanim ishte një çiflig me kulla në bregun e një liqeni, se kishte 100 shtëpi të bukura si edhe shumë vreshta e kopshtije. Duket se, si çiflig që ishte, u prish pas pushtimit grek të 1912-s. Në vijim të udhëtimpërshkrimit bën të ditur se, pasi u qerasën dhe u dëfryen mirë e mire, gjatë zbavitjes, thotë, se u qëllua edhe me topa e pushkë, morën nusen dhe u nisën drejt perëndimit, duke hedhur

valle dhe duke bërë lutjet islame të kohës. Tregon edhe se nuk u kthyen më nëpër udhën që shkuan, po, sipas zakonit, ndoqën një udhë tjetër: atë Zharrovinë-Delvinàq-Libohovë. Për Delvinàqin tregon se ishte një qytezë me 400 shtëpi të banuara krejtësisht prej shqiptarësh të krishterë(25). Rrëfen edhe se atje asokohe gjendeshin edhe 40-50 shitore, 3 hane e 10 kisha. Tregon, gjithashtu, se pas 6 orë të tjera udhëtimi të pandërprerë, prej Delvinàqi arritën në Libohovë. Për të thotë se ishte një vendbanim në rrëzë mali (malit Bureto -I. D. H.) me plot vreshta(26) **iremike(27)** dhe me shumë gurra uji(28). Thotë se Libohova asokohe përbëhej prej 200 shtëpish të mbuluara me rrasa guri, të gjitha të banuara prej shqiptarësh të besimit islam; tregon edhe se në atë vendbanim ndodheshin edhe: një xhami, një mesxhid, një han dhe një banjë. Atje ishte çifligu i të birit të Zejnel Pashait, i cili banonte në një **«shtëpi madhështore që nuk mund të përshkruhet»**. Pikërisht në të e prunë nusen dhe ia dorëzuan beut me shumë madhështi. Nata e gjerdhekut -tregon ai- u festua me dëfrime të shumta kulmore. Pija(29) dhe xhumushi (ahengu) vazhduan deri në mëngjes; u zbrazën 7 voza me raki dhe u hëngrën 2000 berra të pjekur në hell. Në këtë dasmë madhështore dhe të bujshme **«sipas zakonit shqiptar, u kënaqa për një javë rresht»**. Përshkrimi i ceremonisë së asaj dasme -vëren ai- **«mund të formonte një vëllim shumë të trashë, prandaj nuk guxova fare ta nis këtë punë»**. Së fundi tregon se beu i fali një kalë, 100 florinj e 10 copë cohe e stofra të tjera si dhe një orë të bukur. Pasi u përshëndet me të gjithë miqtë e dashamirësit, tok me disa shoqërues të armatosur mori udhën drejt perëndimi. Dy orë më vonë u kthyen në Gjirokastrë. Në vijim të udhëtimpërshkrimeve të veta nëpër fshatra **«me vreshta të shumta»** flet edhe për urën e gurtë të Mehmet Subàshit. Ajo kalonte sipër rrjedhës së lumit të Dropullit; përbëhej prej 3 harqesh: 2 të vegjël anash dhe një i madh në mes. Edhe pse ajo urë është shkatërruar e zhdukur fare që kushedi se kur, vendi ruan ende emrin **«Ura e Subàshit»**.

Udhëtimpërshkrimet e Evlija Çelebiut në vendbanimet e sapopërmendura; si gjirokastritët dhe libohovitët -e më shumë nepravishtarët- me çamët kanë pasur dhe deri-diku vazhdojnë të ruajnë ende thuajse të njëjtat zakone, gati të njëjtin fjalor, të njëjtat veshje, të njëjtat zeje (veçanërisht blegtorinë dhe bujqësinë) etj. Sipas hamendësimeve më të përafërta mund të thuhet pa mëdyshje se këto lloj ngjashmëri kanë rrjedhur si pasojë e shkaqesh thelbësore; një prej tyre mund të ketë qenë qarkullimi i

pandërprerë nëpër rrugën këndngushtë: Çamëri-Janinë-Gjirokastrë e anasjelltas. Qarkullimi me karvanë tregtarësh nëpër këtë udhë ka qenë i hershëm, ndoshta qysh në kohën romake a edhe më parë; por, ai ka qenë gjallërisht i pandërprerë sidomos gjatë 5-qindvjeçarëve të sulltanatit osman. Qarkullimi dhe marrëdhëniet e pandërprera s'kishin se si të mos krijonin kushte edhe për krushqitë e ndërsjellta etj. Mbetet të besohet, pra, se pikërisht këto marrëdhënie të pandërprera shtynë -për shkaqe nga më të ndryshmet- një numër jo të vogël banorësh nga fshatrat e qytetet e Çamërisë që kur e kur të shpërnguleshin prej trojeve të veta zanafillëse dhe të vendoseshin në Gjirokastrë, Libohovë e Nepravishtë, fshat ky në Rrëzën e Zezë, 3 km. në lindje të Libohovës(30). Kjo vërtetohet ngase një numër i madh familjesh libohovite e nepravishtare edhe sot e kësaj dite dihen se janë të prejardhura nga Çamëria; një prej familjeve libohovite ruan ende mbiemrin «**Hunda**», mbiemër ky i një fisi të madh (një grup i tërë shtëpish) në Paramithi. Dëshmi të tjera edhe më bindëse e të prejardhurve çamë në Libohovë, janë edhe mbeturinat ende të vetëruajtura të ish-kalasë «**Çamurjót**» si dhe emri i ish-lagjes libohovite me të njëjtin emër. Një nga familjet nepravishtare me prejardhje të vonë nga Çamëria, ka qenë -dhe vazhdon të jetë ende- familja e madhe e shumëdëgjuar e Çobanatëve si dhe dega kryesore e dalë prej saj, ajo e Asllanatëve. Tërë sapo u përmendën, pra, më detyrojnë pashmangshmërisht që të vë në dukje edhe udhëimpërshkrimet e Evlija Çelebiut në Gjirokastrë - Peshkëpi - Zharrovinë e anasjelltas Zharrovinë - Delvinaq - Libohovë - Gjirokastrë, sado që këto vendbanime ndodhen në krahina jashtë Çamërisë. Lidhur me këtë udhëpërshkrim, Vasil Krapsiti në veprën e vet e caktuar vëren: «**Nga të dhënat që na bën të ditura Evlija Çelebiu del se udhëtimi i tij**» nëpër këtë pjesë të vendit «**merr një rëndësi të veçantë**».

Evlija Çelebiu shëtiti anë e kënd nëpër tërë viset që asokohe përbënin trungun tokësor shqiptar, ashtu si asnjë udhëtar tjetër i huaj. Kjo i dha atij mundësi që të njihje me imtësi çdo shfaqje a sjellje të jetës së përditshme: gjuhën, prirjet, sidomos ato më të parapëlqyerat: burrërinë, trimërinë, besnikërinë ndaj fjalëdhënies, zemërgjerësinë, mëshirën etj. Shkurt, u bë njohësi më i mirë i tyre. Ai vëren: «**Tërë shqiptarët flasin shqip, gjuhë e pangjashme me asnjë gjuhë tjetër... Është gjuhë e mrekullueshme, të cilën ata e flasin me përkushtim (devocion) dhe mirësjellje kur njeri-tjetrit i drejtohen me nderim**». Ndër të tjera ai ngreh në qiell mikpritjen

e shqiptarëve; Në «Sejjahatnamesi» thotë: «I huaji, qoftë edhe fare i panjohur, në Shqipëri është i mirëpritur në cilëndo shtëpi që të flasë dhe se ai mund të rrijë atje sa të dojë. Të zotit të shtëpisë, nëse i mungojnë ushqimet e domosdoshme për të kënaqur të ardhurin, arrin të lërë peng edhe pushkën -mjetin më të çmueshëm dhe jetik për të dhe familjen e tij- për të marrë ç'i duhet».

Vëzhgimet e veta ai i pasqyroi një për një në librin «Evljija Çelebi Sejjahatnamesi». Librin (mjerisht jo të gjithin) së pari e përktheu shqip Sali Vuçiterni dhe më 1930 nën titullin «Shqipëria para dy shekujsh» e botoi në Tiranë, në shtypshkronjën «Shkódra». Përkthimi dhe botimi i këtij libri –edhe pse i gjymtuar rëndë- u prit me kënaqësi të dukshme, por edhe me qortimet e domosdoshme; megjithatë ai s'kishte se si të mos tërhiqte dukshëm vëmendjen e intelektualëve jo vetëm shqiptarë por edhe të shumëkujt përtej Shqipërie. Shkrimtari, publicisti e atdhetari i mirënjohur shqiptar, Mitrush Kuteli, vëren se Evlija Çelebiu në veprën e vet torri besnikërisht ndodhitë e keqnjohura apo fare të panjohura shqiptare të kohës osmane, të përhapura me fjalë të pakripta (trashanike) e sipërfaqësore: «*Pesëqind vjet robëri*». Më tej M. Kuteli thekson se vepra «Sejjahatnamesi» e Evlija Çelebiut “**përbën një monografi me rëndësi të jashtëzakonshme për ndriçimin e kohës së shkuar**”. Në të –vijon ai -shfaqen të gjitha dukuritë e jetës shoqërore dhe ekonomike të vendit tonë: histori, gjeografi, bujqësi, zejtari, tregti, organizim politik dhe fetar, zakone, kulturë, legjenda etj., të cilat i përshkruan me çiltërsi e hollësi të papritura. Në të gjitha tregimet mbi Shqipërinë, karakteri luftarak i shqiptarit zë vend qendror. «**Djalëria shqiptare e këtij qyteti (Beratit)/ -vëren ai- shëtisin krejt të armatosur dhe, ruajna Zot/ se, po u ngatërrove me ta, betohen vetëm/ me shpatën që mbajnë!**». Të njëjtin përcaktim bën edhe për «**rebelët shqiptarë**» -siç i quan ai, sidomos ata të fshatrave të Kurveleshit, të cilët -thotë ai- mbanin - «**pushkë me fitil. Zoti na ruajtë! Betohen me shpatë e jo me argumente fetare**». Libri «Evljija Çelebi Sejjahatnamesi» -përfundon Mitrush Kuteli- «**Nga të gjitha pikëpamjet: shoqërore, ekonomike dhe politike është një thesar i begatshëm për të ndriçuar historinë e popullit shqiptar**». (Shih Paraparathënien e librit dhe fletoren «Shqipëria e Re» nr. 522, Kostancë, dt. 19.02.1933).

Pa mohuar a përçmuar vlerën e botimit të 1930-s, nuk mund të mos theksojmë mangësinë se la jashtë pjesë të veprës së vet, të cilat Evlija Çelebiu i pati përshkruar me aq vërtetësi e përkushtim.

Botimin shqip të librit «Evliaja Çelebi Sejjahatnamesi» më 1930 e çmuan dhe e vlerësuan edhe disa të huaj. Prof. turk, Nexhip Hasimi në shkrimin e vet thotë edhe: «Evliaja Çelebiu...ka përshkruar gjithçka i ka zënë syri: Lartësitë e maleve, madhësinë e qyteteve e të fshatrave, ka matur me kujdes gjatësinë dhe gjërësinë e fortesave, të xhamive e të kishave, ka përshkruar me kujdes të veçantë e pa mungesa ndërtesat e kohës, ka vëzhguar me vëmendje jetën e popujve, gjuhën, fenë, zakonet. Ai është më i madhi i të gjithë turistëve muslimanë të Mesjetës, duke ua kaluar edhe Messeudiut, Ibn-i Fadlanit, Idrisiut, Ibn-i Metutas etj».

Botimi i cunguar i 1930-s u rishtyp në vitin 2000 po në Tiranë, nën titullin «Shqipëria 350 vjet më parë», në shtypshkronjën «Horizont». Botimi i 3-të shqip -që edhe ky lë pa përkthyer udhëtimin në Janinë e Çamëri- u bë në vitin 2008; këtë herë jo botimi i përkthyer nga Sali Vuçiterni, po ai i përgatitur nga Robert Elsie dhe i botuar prej tij në vitin 2007 në Hågë(Hollandë). Robert Elsieja në parathënien e vet vëren se «Sejjahatnamesi e Evlijja Çelebiut ...për Shqipërinë e qindvjeçarit të 17-të -veçanërisht për brendësinë e këtij vendi- është një minierë të dhënash, një veper me vlera të pakrahasuara. Burime të tjera për historinë e Shqipërisë së kësaj kohe gjenden rrallë....Po, për nga vlera dhe rëndësia të gjitha ato janë të zbehta në krahasim me udhëtimpërshkrimet e Evlijja Çelebiut; në të jepen të dhëna habitërisht të përpikta për pazaret, kalatë, xhamitë, për vendet e nderimit dhe sheshet e argëtimit...Të dhënat e përshkruara në «Sejjahatnamesi» të Evlijja Çelebiut për qytetet dhe fshatrat shqiptare na zbulojnë se këto ngërthenin të gjithë përbërësit e një kulture islame të përpunuar hollë, nga e cila tragjikisht gjatë rrjedhave të historisë vetëm pak gjurmë kanë shpëtuar».

Edhe në botimin e osmanologut Franc Babinger, Berlin 1938, mbetet jashtë përkthimit udhëtimi i tretë i Çelebiut në vitin 1670 nëpër Çamëri dhe Mollosi.

Për të plotësuar këto mangësi në përkthimet e veprës *Sejjahatname* të udhëtarit turk Elvija Çelebiu në gjuhën shqipe e pamë të arsyeshme përkthimin dhe botimin e kësaj pjese të mohuar për shqiptarët prej *Sejjahatname*-s. Me shpresën e sjelljes së veprës Çelebiut më të plotë e me përfshirje të trojeve shqiptare, Çamëri e Mollosi të neglizhuara në përkthimet e mëparshme.

## Shënimet:

1. Shenjti i Sjellshëm.
2. I biri i dervish Mehmed Ziliut.
3. I shënuar në Arkivin e Institutit të Historisë me shenjë A. III.205
4. Vendësit e quajnë Lefkàdhë, ngase toka e saj përbëhet prej dheu të kuq (argjilë e kuqe). Ndërsa pushtuesit mesjetarë latinë, e quanin Santa Maura.
5. «Evliaja Çelebi Serjjahatnamesi», fq. 637.
6. Luftanije të moçme. (F. A. I. H. Dos. 78 – E 2(8).
7. Nga sa thotë, pa dyshim që e ka fjalën për qytetën me kala-fortesë, të quajtur Mitikë.
8. S'ka kuptim, mungon folja. Do ta krahasoj me origjinalin – I.D. Hoxha.
9. Nar, (tq.: shegë).
10. Vilajeti i Janinës.
11. “Evliaja Çelebi Sejajahatnamesisë”, fq. 646-656.
12. “Evliaja Çelebi Sejajahatnamesisë”, fq.fq. 659 e 670
13. Duket se qyteti i hershëm –ai ndoshta që i fillimit të mesjetës-asokohe ishte lënë shkretë; i riu ishte ndërtuar në vend të shtruar poshtë të parit. Mbeturinat e të hershmit mbase vetëruhen ende.
14. «Evliaja Çelebi Sijjahatnamesi», fq. 659 e 670.
15. Qimja e Pejgamberit, a. s.
16. «Evliaja Çelebi Sejajahatname» VIII, fq. 663.
17. Doemos që e ka fjalën për kruan në qendër të qytetit, të quajtur «Kroi i Bajos».
18. Vasil Krapsiti në veprën e vet «I ΙΣΤΟΡΙΑ ΤΟΥ ΜΑΡΓΑΡΙΤΙΟΥ» tregon se venecianët emrin «Gjitanë» e zëvendësuan me emrin e ustait kalangritës, Margaritit. Po, popullata vendëse –falë shqipes së folur prej saj dhe krejt çamëve të tjerë- me kohë e ndryshoi në Margëllëç.
19. (Shih, Ibrahim D. Hoxha, «Enciklopedi Jugshqiptare» I, fq. 792-795).
- (20). Sejajahatnamesisë», fq. 664.

(21). Në shënimin 131, fq. 64 të librit «**Evliaja Çelebiu në Shqipëri dhe viset fqinje: Kosovë, Mal i Zi, Òhër**» të përgatitur nga Robert Elsie dhe të përkthyer nga anglishtja prej Abdyrrahim Myftiut, të botuar në Tiranë më 2008 nga shtëpia botuese «55», për Zharrovinën thuhet: «**Vendi i saktë nuk dihet, por ndoshta është në afërsi të fshatrave greke: Pondikates, Pogoniàni, Dolo dhe Faràngi, të gjithë në V-P të Delvinàkut**». Evlija Çelebiu e përcakton fare shkoqur vendndodhjen e Zharrovinës: 4 orë në lindje të Delvinaqit. Ndërsa botuesit e përkthimit thonë: «**në V-P.**», duke përgënjeshtuar kështu vetëveten. E dyta, tre nga fshatrat e sapopërmendura janë malore; vetëm Delvinaqi ndodhet në një luginë disi të shtruar dhe se vet ky quhet edhe Pogonian. E. Çelebiu vendndodhjen e Zharrovinës e përcakton pa mëdyshje: «**në buzë të një liqeni**». Po sidomos 3 nga fshatrat e lartpërmendur nga ata janë malorë dhe pa kurrfarë shenje liqeni pranë tyre. E treta, Pondikati deri në pushtimin grek(1912) nuk ka qenë i banuar prej «**grekësh**», po nga shqiptarë.

(22). Është quajtur «**Rrëza e Zezë**», ndoshta për shkak të gjelbërimit të vazhdueshëm

(23). Fshat në krahinën malore pogoniàne të përtej kufirit të sotëm shtetëror.

(24). S'dallohet mirë, ngase përsipër H-së a **И**-së kalon viza rrugëshënuese.

(25). Politika kryqtare athino-fanarite shqipshfarosëse e ushtruar nëpërmjet kishës dhe shkollave greqishtpërdoruese, këta shqiptarë, me kalimin e viteve ca nga ca i shndërroi në grekër.

(26). E ka fjalën për pllajën e quajtur **Revan** që shtrihet sipër vendbanimit; kjo pllajë disi e **shtruar**, edhe sot përmendet për vreshtarinë e dikurshme.

(27). Iremi, qytet i përmendur në Kur'an-i Qerim.

(28). Më ujëshuma është e quajtura **Zhepë** apo **Gushnicë**.

(29). Vetëm kjo ishte e ndryshme; në dasmat çame nuk përdorej kurrë rakia, po bakllavaja dhe kafja.

(30). Të shpërngulur të herëpashershëm (masivisht) prej Çamërie janë edhe ata që krijuan fshatin Dardhë të Devollit, fshatin Nikolicë e Zharkan të Kolonjës etj. Kurse shpërngulje tek e tek apo në grupe të vogla janë vendosur edhe në **Dibër të Madhe**.